

Në bazë të nenit 27, paragrafit 1, pikës 6, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.09.2019, e miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E POLITIKAVE TË UNIVERSITETIT PËR PROGRAMIN “PUNË – STUDIM”

I. Objekti i rregullimit

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet me të cilat studentët mund të përfitojnë nga programi “Punë-studim” në përputhje me politikat financiare të Universitetit.

II. Përzgjedhja e studentëve

Neni 2

(1) Programi për mbështetje financiare “Punë-studim” për çdo vit akademik alokohet në nivel qendror në Buxhetin e Universitetit në përputhje me dispozitat buxhetore.

(2) Si pjesë e pakos për ndihmë financiare Universiteti u ofron studentëve mundësi për angazhim në programin “Punë-studim” sipas kushteve të mëposhtme:

- pagesa e studentit nuk mund ta tejkalojë koston për shkollim (tuition) për vit akademik;
- studentët e angazhuar në këtë program mund të punojnë më së shumti 12 orë në javë, gjatë periudhës së ligjëratave;
- përzgjedhja e studentëve bëhet në bazë të nevojës për ndihmë financiare dhe të aftësive për vendin e punës;
- konflikti i interesit duhet të deklarohet paraprakisht dhe mund të ndikojë në punësim.

Neni 3

Të drejtë aplikimi në këtë program kanë të gjithë studentët, që i ndjekin studimet e rregullta në UEJL.

Neni 4

Studenti ka të drejtë të angazhohet dy vite radhazi në këtë program, në raste kur përgjegjësi i departamentit vlerëson se studenti i angazhuar në vitin paraprak ka treguar paraqitje të jashtëzakonshme dhe e arsyeton nevojën për vazhdim, në pajtim me nenin 2, të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Studentit, i cili ka bursë të plotë, apo ndihmë tjetër financiare që e mbulon koston e plotë për shkollim (*tuition*) për vitin gjegjës akademik, nuk i lejohet të angazhohet në programin “Punë-studime” në vitin e njëjtë akademik.

Neni 6

(1) Studenti që dëshiron të përfitojë nga kjo mundësi, duhet ta plotësojë aplikacionin, i cili mund të merret në Zyrën për ndihma financiare. Kjo zyrë është përgjegjëse për

njoftimin e vendeve të lira të punës, si dhe për përpunimin dhe shqyrtimin e kërkesave.

- (2) Pas përpunimit dhe shqyrtimit të kërkesave, studentët i nënshtrohen edhe procesit të intervistës/testimit, nga përfaqësuesit e departamenteve ku kanë aplikuar.
- (3) Përzgjedhja e studentëve që angazhohen në programin “Punë-studim” bëhet duke marrë në konsideratë gjendjen financiare të studentit dhe pikët nga intervista/testimi.
- (4) Departamenti, ose zyra që ka nevojë për një vend pune, do ta japë vendimin përfundimtar për angazhimin në punë të studentit.
- (5) Studenti i cili nuk është pranuar, mund të ankohet me shkrim deri tek drejtori i Shërbimit të studentëve, i cili më pas mund të kërkojë rishqyrtim të vendimit.

III. Evidenca për angazhimin e studentëve

Neni 7

- (1) Përfaqësuesit e departamenteve janë të obliguar të mbajnë evidencë për angazhimin e studentit në punë dhe në raport mujor t’ia raportojnë orët e punës Zyrës për ndihma financiare. Ato, gjithashtu, sigurojnë raport për performancën e studentit, pasi ai të ketë përfunduar me angazhimin.
- (2) Me kërkesë, studentit i lëshohet letër reference nga mbikëqyrësi i njësisë akademike ose administrative, ndërsa Zyra për ndihma financiare, në bazë të evidencës lëshon vërtetim për periudhën e angazhimit në programin “Punë-studim”, si dëshmi e përvojë së punës.

Neni 8

Zyra për ndihma financiare obligohet që pas mbarimit të çdo semestri, të evidentojë dhe informojë studentin për shumën e mjeteve që ka përfituar, si rezultat i punës së kryer.

IV. Dispozitat përfundimtare

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi më 01.10.2019.